



Tiranë, më 22.11.2019

Lënda: Informacion për mosrealizimin e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore në Organet e Qeverisjes Vendore 2019, të Partisë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë.

**Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve
Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri**

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) nr. 740, datë 31.05.2019 dhe kontratës së shërbimit në zbatim të tij, jam angazhuar në cilesinë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar për misionin me objekt:

- Kryerjen e monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore të partive politike dhe,
- Kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet në Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019, nga Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë(ADK).

Për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, menjëherë pas lidhjes së kontratës me KQZ-në, më datë 01.06.2019, ne kërkuam dhe vendosëm komunikimin zyrtar me drejtuesit e Partinë ADK, të cilët qenë bashkëpunues gjatë procesit të monitorimit dhe na deklaruan se për fushatën zgjedhore vendore 2019 nuk do të zhvillonin asnjë aktivitet dhe për rrjedhim nuk kishin parashikuar të ardhura dhe shpenzime në funksion të fushatës.

Por pavarësisht informacioneve dhe deklarimeve të partisë për mungesën e plotë të aktiviteteve elektorale, ne vazhduam procesin e monitorimit në terren për përmbushjen e objektit të parë të kontratës, kryerjen e monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore.

Ashtu siç është përshkruar dhe në raportin e hartuar për këtë çështje, si nga deklaratimet e partisë dhe nga monitorimi në terren i aktivitetit elektoral, rezultoi se Partia ADK, nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet zgjedhor dhe nuk ka realizuar të ardhura dhe kryer shpenzime për fushatën zgjedhore vendore 2019.

Në kushtet e mungesës së plotë të aktiviteteve elektorale, dokumenteve dhe transaksioneve për të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me fushatën zgjedhore, objekti i kontratës për "Kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet në Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019, nga Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë", nuk është realizuar.

Faleminderit për mirkuptimin.

Audituesi Ligjor (Ekspert Kontabël i Regjistruar)
(firma)

Afrim Suli